



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

V E N D I M

Nr. 37, Datë 17/04/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 131, datë 17.10.2019, e znj. H.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesja ka filluar punë në vitin 2010 pranë Q.T.N.G. Patos, të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Në fundin e vitit 2013, ankuesja është emëruar në pozicionin brigadier pranë QASHNG Patos dhe në muajin prill 2016, ajo është emëruar në pozicionin ndihmës/operator prodhimi pranë së njëjtës Qendër.

Nëpërmjet shkresës nr. 6417, datë 23.07.2018, së Albpetrol sh.a., ankuesja H.B. është njoftuar për ndërprerjen të marrëdhënieve të punës me Albpetrol sh.a., për shkak të ristrukturimit të shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të punës me këtë Shoqëri janë ndërprerë në datën 31.10.2018. Ankuesja thekson faktin se edhe bashkëshorti i saj, i cili punonte pranë Albpetrol sh.a. është larguar nga puna, në kuadër të ristrukturimit të shoqërisë dhe aktualisht janë të dy të papunë.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se ajo i plotësonte të gjitha kriteret për të qëndruar në punë dhe për t’u mos përfshirë në ristrukturim, por Albpetrol sh.a. e ka larguar nga puna, për shkak të bindjeve të saj, politike, të djathta.

¹ Referuar shkresës nr. 35 Prot., datë 17.12.2009, të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mallakastër etj.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 131, datë 17.10.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a., me shkresën nr. 1379/1, datë 24.10.2019, ku kërkohej informacion, lidhur me situatën e parashtruar nga ankuesja. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijëni edhe ankueses. Informacioni i kërkuar konsistonte në çështjet e mëposhtëme:
- Kopje e kontratës së punës së ankueses me Albpetrol sh.a. si dhe Urdhërat e emërimit të saj në të gjitha pozicionet e punës, që ajo ka mbajtur pranë Albpetrol sh.a.;
 - Kopje e librezës së punës së ankueses;
 - Informacion, nëse ndaj ankueses janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës, që ka punuar pranë Albpetrol sh.a., si dhe kopje të akteve përkatëse administrative;
 - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite pranë Albpetrol sh.a., si dhe kopje të vlerësimeve të punës për të gjithë ndihmës operatorët e prodhimit që kanë punuar pranë Q.A.SH.N.G. Patos, Fier;
 - Kopje e praktikës së përfshirjes së ankueses në pushim kolektiv:
 - Njoftimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankueses, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
 - Vendimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankueses, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
 - Proçesverbalet e vlerësimit me pikëzim për ankuesen, si dhe të gjithë punonjësit, që kanë punuar në pozicionin e ankueses pranë Q.A.SH.N.G. Patos, Fier;
 - Dokumentacioni i dosjes personale, për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur, përfshirë ankuesen.
 - Numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.A.SH.N.G. Patos, Fier, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna;
 - Numri i përgjithshëm i ndihmës operatorëve të prodhimit, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna pranë Q.A.SH.N.G. Patos, Fier;
 - Kopje e strukturës së mëparëshme dhe strukturës aktuale të Q.A.SH.N.G. Patos, Fier.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 1579/2, datë 21.11.2019, nëpërmjet së cilës informon se znj. H.B. është punonjëse e shoqërisë Albpetrol sh.a., që nga data 01.07.2010. Gjatë marrëdhënieve të punës me shoqërinë, ajo ka punuar në këto pozicione pune:

- Punëtore në QTNG Patos, nga data 01.07.2010 - 01.11.2011;
- Punëtore gatishmërie pranë Q.L.H.P.R. Patos, nga data 01.11.2011 – 02.05.2013;
- Punëtore shërbimi pranë Q.L.H.P.R. Patos nga data 02.05.2013 – 01.12.2013;
- Brigadiere pranë QASHNG Patos nga data 01.12.2013 – 13.04.2016;
- Ndhmës operator prodhimi nga data 13.04.2016 – 01.11.2018.

Në vijim Albpetrol sh.a. thekson faktin se sikurse e ka bërë me dije edhe më parë Komisionerin, në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Shoqërisë dhe Vendimin nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, kjo shoqëri është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye, mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore, kjo shoqëri ka ndërmarrë hapat përkatëse për fillimin e procedurave të pushimit kolektiv, duke njoftuar punonjësit, që preken nga ky proces.

Në rastin konkret, në Qendrën QASHNG Patos është kryer një riorganizim tërësor i saj, duke prekur edhe Sektorin 16/1, Usojë, sektor në të cilin janë shkurtuar të gjithë vendet e punës.

Për sa më sipër, referuar strukturës së re, organizative, të miratuar për Sektorin 16/1, Usojë, në Qendrën QASHNG Patos janë shkurtuar të gjitha pozicionet e punës, përfshirë edhe pozicionin e punës “ndihmës operator prodhimi”. Referuar procesit të kryer për punonjësit e Qendrës QASHNG Patos, rezulton se znj. H.B. i është suprimuar pozicioni i punës. Për këtë arsye, mbështetur në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës, ankuesja është njoftuar me shkresën nr. 6417, datë 23.07.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës.

Albpetrol sh.a. sqaron se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesen nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv, për shkak të numrit të punonjësve, të cilët janë të përfshirë në këtë proces. Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës- punëmarrës, pra raporti ndërmjet shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe znj. H.B. nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e saj për diskriminim për shkak të bindjes politike. Përzgjedhja e punonjësve, të cilët do të vazhdojnë marrëdhëniet e punës dhe të punonjësve që do t’ju ndërpriten këto marrëdhënie, nuk ka patur asnjë kriter diskriminues, por është kryer mbi bazën e pikëzimit nga një Komision i Posaçëm. Proçesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimit të fuqisë punëtore është një proces dinamik, që ka prekur punonjës të profesioneve, moshave dhe vjetërsive të ndryshme në punë.

Për sa i përket pretendimit të znj. H.B. se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, Albpetrol sh.a sqaron se ky pretendim është i pabazuar, pasi shoqëria nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por vetëm të dhëna personale të punonjësve, në

përputhje me legjislacionin në fuqi. Në asnjë praktikë apo shkresë të punëdhënësit nuk është përmendur përkatësia politike e ndonjë prej punonjësve.

Në shoqërinë Albpetrol sh.a. janë paraqitur ankesa nga punonjës të prekur nga ristrukturimi, të cilët pretendojnë përkatësinë dhe bindje të ndryshme politike, fakt i cili hedh poshtë pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike.

Albpetrol sh.a. thekson faktin se pala ankuese ka barrën e provës të vërtetojë me prova shkresore që punëdhënësi ka qenë zyrtarisht në dijeni të përkatësisë politike të ankueses, pasi është logjike që të diskriminosh dikë për shkak të bindjeve politike, duhet të kesh dijeni mbi këto bindje. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale të ankueses nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë e saj politike.

Në shkresën e Albpetrol sh.a. sqarohet se kjo shoqëri nuk disponon kopje të librezës së punës së ankueses, si dhe në dosjen e saj personale nuk rezultojnë të administrohen shkresa për dhënie masash disiplinore në ngarkim të saj apo vlerësime pune, gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë kësaj shoqërie.

Bashkëlidhur shkresës së Albpetrol sh.a. është dërguar dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Kopje e kontratës individuale të punës për znj. H.B. ;
2. Kopje e strukturës aktuale dhe strukturës së mëparshme të Qendrës QASHNG Patos;
3. Vendimi nr. 956, datë 31.10.2018, i Administratorit të Albpetrol sh.a.;
4. Njoftimi nr. 641, datë 23.07.2017, i Administratorit të Albpetrol sh.a., në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ankuesen;
5. Proçesverbalet e mbajtura nga Komisioni i Vlerësimit dhe Pikëzimit, për të gjithë Qendrën QASHNG Patos;
6. Kopje të dosjeve të personelit të punonjësve të dektorit 16/1 Usojë, të QASHNG Patos.

C. Në vijim të ndjekjes së proçedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 17.01.2020, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore morën pjesë ankuesja dhe përfaqësuesja e Albpetrol sh.a., e cila depozitoi aktin Autorizim nr. 11376, datë 12.12.2020, të nënshkruar nga Administratori i kësaj shoqërie. Ankuesja H.B. parashtroi edhe një herë pretendimet e saj kundër Albpetrol sh.a., duke theksuar faktin se bindja politike ka qenë arsyeja kryesore që Albpetrol sh.a. e ka përfshirë në pushim kolektiv, si atë edhe bashkëshortin e saj. Ajo u shpreh se tendenca për ta larguar atë nga puna ka filluar me ardhjen në pushtet të forcës politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Në vitin 2016, ajo është transferuar nga pozicioni i brigadieres, në pozicionin e ndihmës/operatores së prodhimit. Në vijim, ajo është përfshirë në pushimin kolektiv të zbatuar gjatë vitit 2018. Përveç, bindjes politike, ankuesja theksoi faktin se familja e bashkëshortit të saj ka qenë familje të përndjekurish politikë, fakt të cilin ajo e shtoi si shkak tjetër diskriminimi. Ankuesja u shpreh se ajo duhet të ishte ripunësuar sërisht pranë Albpetrol sh.a., pasi ky i fundit kishte kryer punësime të reja pas punësimit kolektiv.

Përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. u shpreh se znj. H.B. është përfshire në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. pasi pozicioni i saj i punës është suprimuar/shkurtuar. Në kushtet e shkurtimit të pozicionit të punës, ajo nuk i është nënshtruar vlerësimit me pikëzim. Në kushtet kur, në marrëveshjen me Sindikatat e punonjësve dhe Albpetrol, ishte rënë dakord që për punonjësit e Albpetrol sh.a. që ishin të përndjekur politike, të mos i nënshtroheshin pushimit kolektiv, përfaqësuesja e Albpetrol sh.a u shpreh se ky parashikim nuk vlente, kur pozicioni i punës shkurohej apo mbyllej. Ajo u shpreh gjithashtu se shoqëria nuk kishte aspak dijeni mbi bindjet politike të ankueses, si dhe kriteri i bindjes politike nuk ishte përcaktuar si kriter punësimi nga Albpetrol sh.a. Përfaqësuesja e Albpetrol u shpreh se do të kryente verifikimet përkatëse lidhur me pretendimin e ankueses, se shoqëria nuk i kishte kthyer përgjigje ankesës së saj pas përfshirjes së saj në pushim kolektiv. Përfaqësuesit e KMD i kërkuan përfaqësueses së Albpetrol sh.a. të kryente verifikime, nëse ankuesja kishte depozituar kërkesë për ripunësim pranë Albpetrol sh.a., në vijim të ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me këtë shoqëri, si pasojë e pushimit kolektiv.

1. Në vijim, përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. dërgoi me e-mail, në datën 04.02.2010, kopje të ankesës së datës 27.07.2018, së znj. H.B. drejtuar Albpetrol, ku shpreheshin kundërshtimet e saj për përfshirje në pushim kolektiv dhe përgjigjen përkatëse nr. 8510/1, datë 07.09.2018, të Albpetrol sh.a. drejtuar ankueses. Njëkohësisht, përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. thekson faktin se znj. H.B. nuk kishte depozituar asnjë kërkesë për ripunësim pranë kësaj shoqërie.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Znj. H.B. ka punuar pranë Albpetrol sh.a. që prej vitit 2010, duke mbajtur pozicione te ndryshme pune. Referuar akteve të administruara në cilësi prove gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së saj, rezulton se ajo ka punuar si punëtoare në QTNG Patos, nga data 01.07.2010 - 01.11.2011. Në vijim ka punuar punëtoare gatishmërie pranë Q.L.H.P.R. Patos, nga data 01.11.2011 – 02.05.2013. Nga data 02.05.2013 – 01.12.2013, Znj. H.B. ka punuar punëtoare shërbimi pranë Q.L.H.P.R. Patos. Më pas, është emëruar brigadiere pranë QASHNG Patos, ku ka punuar nga data 01.12.2013 – 13.04.2016. Në datën 13.04.2016 është emëruar ndihmës operator prodhimi pranë së njëjtës Qendër, detyrë, të cilën e ka mbajtur deri në datën 01.11.2018. Në këtë datë, marrëdhëniet e punës së znj. H.B. me Albpetrol sh.a. janë ndërprerë pasi pozicioni i saj i punës është suprimuar, në kuadër të ristrukturimit të përgjithshëm të Albpetrol sh.a.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesën rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë

25.06.2018, e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a. është duke zbatuar një proces ristrukturimi, si rrjedhim i së cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1.Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë *“Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”* parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njëjësive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë të të përcaktoreshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol

sh.a., vlerësimi nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtuohet, nuk i nënshtroheshin vlerësimi nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimi të ngritura në çdo qendër.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të QASHNG Patos, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve pranë kësaj Qendre. Referuar strukturës organike paraardhëse dhe strukturës aktuale të QASHNG Patos, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve është ulur nga 124, në 93 punonjës. Pra, për sa më sipër rezulton se 31 punonjës të kësaj qendre i janë nështruar pushimit kolektiv. Njëkohësisht, rezulton se Stacioni 16.1, Usojë është suprimuar totalisht. Stacioni 16.1., Usojë, ka patur në organikë 12 punonjës, nga të cilët 4 ndihmës operatorë prodhimi, të cilët i janë nështruar pushimit kolektiv.

Për këtë arsye, mbështetur në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës, të gjithë punonjësit që i janë nështruar pushimit kolektiv janë njoftuar për ndërprerje të marrëdhënies së punës me shoqërinë. Ankuesja është njoftuar me shkresën nr. 6417, datë 23.07.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës. Në vijim, znj. H.B. i është dërguar Vendimi nr. 956, datë 31.10.2018, nëpërmjet së cilit ndërpriten marrëdhëniet financiare dhe ato të punës në datën 01.11.2018.

Në vijim të këtij procesi, znj. H.B. i është drejtuar drejtuar Albpetrol, me ankesën e datës 27.07.2018, ku shpreheshin kundërshtimet e saj për përfshirje në pushim kolektiv. Në përgjigje të ankesës së saj, Albpetrol sh.a. ka dërguar shkresën përkatëse nr. 8510.1, datë 07.09.2018, ku ankuesja sqarohet se ajo i është nështruar pushimit kolektiv, pasi Stacioni 16.1. Usojë është shkurtuar dhe se procedurat e ndjekura ndaj saj kanë qenë ligjërisht të rregullta. Shkresa e Albpetrol sh.a. është shoqëruar edhe nga mendimi ligjor i Drejtorisë Juridike të kësaj shoqërie, që ka marrë në analizim të gjitha procedurat e ndjekura nga QASHNG Patos ndaj ankueses.

Sikurse u përmend edhe më sipër, rezulton se të gjithë punonjësit e Stacionit 16.1, Usojë, i cili është suprimuar, i janë nështruar pushimit kolektiv, ndër të cilët edhe ankuesja, e cila punonte në pozicionin e ndihmës operatores së prodhimit. Në referencë të shkresës nr. 5537, datë 02.07.2018, së Albpetrol sh.a., rezulton se në çdo Komision Vlerësimi të ngritur pranë çdo qendre prodhimi apo shërbimi, në varësi të Albpetrol sh.a., bën pjesë në cilësinë e anëtarit edhe një përfaqësues i Sindikatës së Naftëtarëve, i cili është përfaqësues i punonjësve të Albpetrol sh.a. Kjo shërben si një garanci për të gjitha veprimet e kryera nga Komisionet përkatëse, pasi përfaqësuesit e Sindikatës mbrojnë interesat e punonjësve të Albpetrol sh.a.

Lidhur me pretendimin e ankueses se ajo nuk është ripunësuar sërish pranë Albpetrol sh.a., ndërkohë që shumë ish-punonjës të larguar me anë të pushimit kolektiv janë ri-punësuar, Komisioneri gjykon se në kushtet kur ankuesja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë me shkrim pranë kësaj shoqërie, ku të kërkohej ripunësim, nuk mund të kemi një pretendim të mbështetur nga ana ligjore. Referuar informacionit të dhënë nga ankuesja rezulton se, në vijim në datën 31.10.2018, ajo ka filluar punë pranë Ujësjellës sh.a.

Pretendimi për diskriminim për bindje politike i znj. H.B. konsiston në largimin e saj nga puna për shkak të pushimit kolektiv, fakt që Komisioneri gjykon se nuk është i mbështetur, në kushtet kur nga QSHNG Patos janë larguar 31 punonjës si pasojë e ristrukturimit. Njëkohësisht, një argument akoma më mbështetës i kësaj llogjike qëndron në faktin se i gjithë sektori ku punonte ankuesja është shkurtuar.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të znj. H.B., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana e Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak – bindja politike